

QYTETARËT AKTIV



ZGJEDHJET NË VENDET DEMOKRATIKE

ALTIN (14), LEONIT (16), RINOR (15), ARBENITA (15), KRENARE (14), ERZA (14), BERAT (15)



Ne, nxënësit e Sh.F.M.U. „Emin Duraku“ dëshirojmë të paraqesim mendimet tona për demokracinë dhe zgjedhjen e përfaqësuesve

Demokracia është një ndër format e qeverisjes së një vendi. Elementi kryesor për një shtet të lirë e të pavarur është demokracia. Me demokraci nënkuptojmë lirinë, respektin dhe të gjitha të drejtat të cilat e bëjnë një shtet demokratik. Demokraci, do të thotë të mendosh lirshëm, të kontribuosh për shtetin dhe qytetin tënd dhe të marrësh pjesë në vendimmarrje. Një mënyrë për të marrë pjesë në vendimmarrje është të shfrytëzosh të drejtën e votës. Moshë e cila cilësohet si ideale për të votuar është mosha mbi 18 vjeç, atëherë kur çdo person fiton të drejtën e votës së lirë.

Në Kosovë kemi dy lloje të zgjedhjeve. Ato janë: zgjedhjet parlamentare dhe zgjedhjet komunale. Ato mbahen çdo 4 vite. Zgjedhjet komunale janë zgjedhje të cilat mbahen në vendbanime më të vogla, në të

gjitha komunat e Kosovës. Në këto zgjedhje, qëllimi kryesor është zgjedhja e kryetarit të komunës dhe të asamblesë komunale. Ndërsa zgjedhjet parlamentare janë ato zgjedhje të cilat shërbejnë për përzgjedhjen e përfaqësuesve të popullit, të cilët punojnë në Kuvendin e Kosovës. Prandaj, këto zgjedhje quhen zgjedhje parlamentare. Si pjesë përbërëse kryesore e Kuvendit të Kosovës, janë deputetët të cilët kanë për detyrë paraqitjen dhe mbrojtjen e interesave të qytetarëve.

Ne si nxënës së klasës së 9-të në fund të këtij viti kemi për të bërë një zgjedhje shumë të rëndësishme për jetën tonë. Ajo është të vendosim se ku do të vazhdojmë studimet tona. Kur të bëjmë një zgjedhje preferojmë që kjo zgjedhje të jetë nga brendësia e zemrës sonë dhe jo nga dëshira e të tjerëve. Fatmirësisht demokracia në shtetin tonë na lejon që këtë zgjedhje ta bëjmë pa kurrfarë kufizimi. Kjo do të thotë se dëshirat dhe mendimet e një populli vlejnë.



Grupi i gazetarëve të këtij artikulli



Ja si duket një vendvotim

DEMOKRACIA SI FORMË E QEVERISJES

BUTRINT (14), AULON (14), LIBERTA (14), VESA (14) REONESA (14), VALDRIN (14), EDMOND (14)

Në një vend demokratik, shteti investon në shkollimin tonë. Kështu, shteti na siguron të drejtën e arsimimit. Por ne, shtetit këtë investim do t'ia kthejmë me punë, secili në profesionet tona.

Demokracia është formë e qeverisjes nga populli, për popullin. Fjala demokraci rrjedh nga fjalët greke „demo“ që do të thotë popull dhe „kratia“ që do të thotë udhëheqje. Populli e udhëheq një vend demokratik me anë të votës në zgjedhje të lira. Në demokraci është me rëndësi të mbizotëroj respekti, bashkëpunimi, të drejtat themelore të njeriut etj.

Një shtet demokratik siç është Kosova na siguron të drejtën e arsimimit, të drejtën e punës, të drejtën e shprehjes së lirë etj. Demokracia ndahet në demokraci të drejtpërdrejtë dhe demokraci përfaqësuese.

Ne jemi të lumtur që Republika e Kosovës është një shtet i pavarur dhe demokratik.



Gazetarët e këtij artikulli

Unë e kuptova që Kosova ka demokraci përfaqësuese parlamentare. A e din pse Edmond?!




Auloni duke e pyetur Edmondin

Po Aulon, sepse ne në Kosovë kur dalim në zgjedhje qendrore, votojmë deputetët.



Edmondi duke u përgjigjur

Hmm e kundërta e demokracisë qenka autokracia.



Liberta duke menduar për demokracinë


Po në vendet e tjera, a ka demokraci?



Valdrini duke menduar



Grupi i parë gjatë aktivitetit



Ndërtesa e Pushtetit Ekzekutiv



Duke bashkëpunuar




Liberta dhe Vesa



Duke ndihmuar njëri tjetrin



Bashkëpunimi në grup



Gjykata



Krenarja duke vizatuar

NDARJA E DETYRAVE NË KOSOVË

ERLETA (13), LAURESA (14), RITA (14), DONAT (14), DIONIT (14), RION (14), ENJËLL (14)



Ndarja e punës është zgjidhja ideale për kryerjen e detyrave në mënyrë të barabartë

Ne në klasën tonë i ndajmë punët varësisht prej kërkesave tona, për shembull me rastin e zgjedhjes së kryetarit, arkatarit dhe sekretarit të klasës.

Në fillim të vitit shkollor, ne në klasë diskutojmë për nxënësit të cilët janë më të përkushtuar dhe më të përgjegjshëm për ushtrimin e detyrës së kryetarit, sekretarit dhe arkatarit të klasës.

Edhe në vendin tonë, ndodh e njëjta gjë kur është fjala për ndarjen e punëve të rëndësishme shtetërore, e që ndryshe e quajmë ndarje e pushtetit.

Pushteti në Kosovë ndahet në tri degë: Pushteti Legjislativ, Ekzekutiv dhe Pushteti Gjyqësor.

Secili prej këtyre pushteteve e kanë rëndësinë e vet dhe punën e tij, sikurse shembulli që e morëm me ndarjen e roleve brenda klasës sonë.

Pushteti Legjislativ është pushtet i cili realizohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Pushteti Legjislativ i kryen disa funksione: funksionin legjislativ, përfaqësues dhe kontrollues.

Kuvendi ka funksion legjislativ, sepse detyrë e deputetëve është t'i miratojnë ose mos t'i miratojnë ligjet. Kuvendi i Kosovës ka gjithsej 120 deputetë, ku 20 prej tyre i përkasin komuniteteve jo shumicë. Funksioni përfaqësues i Kuvendit konsiderohet i tillë, sepse deputetët janë ata të cilët votohen prej qytetarëve dhe ata na përfaqësojnë neve në Kuvendin e Kosovës.

Funksioni kontrollues i Kuvendit do të thotë se deputetët pasi që zgjedhin Qeverinë, duhet ta kontrollojnë punën që e bën Qeveria. Qeveria njihet si Pushteti Ekzekutiv, sepse ka për detyrë t'i zbatojë ligjet e miratuara nga Kuvendi dhe të propozojë ligje në Kuvendin e Kosovës.

Pushtetin Gjyqësor e kanë gjykatat të cilat merren me personat të cilët e kanë thyer ligjin. Kemi tri lloje të gjykatave: Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme.

Ne besojmë se mënyra më e mirë për realizimin e punës në nivelin e duhur është të bëhet ky lloj i ndarjes së pushtetit, sepse vetëm kështu secili pushtet i kryen detyrat e tij në mënyrë të pavarur dhe në këtë mënyrë shteti funksionon shumë më mirë.



Autorët e artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org